

RREGULLORE

MBI ORGANIZIMIN DHE TË FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHUMË-PALËSH MBI PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR

Misioni	2
Hyrje	2
Takimet	2
Anëtarësia dhe drejtimi	3
Sekretariati	4
Komunikimi	4
Roli dhe përgjegjësitë	5
Aktivitetet	6
Hartimi i Planit kombëtar	6
Implementimi i Planit	7
Vetëvlerësimi afat-mesëm	7
Mekanizmi i Pavarur i Vlerësimit	8

Misioni

Komiteti Shumë-Palësh mbi Partneritetin për Qeverisje të Hapur ka për qëllim të sigurojë një dialog konstruktiv dhe të hapur midis Qeverisë së Shqipërisë dhe palëve të interesuara të Shoqërisë Civile dhe aktorëve të tjerë si akademia, sektori privat.

Krijimi i Komitetit Shumë-Palësh të Këshillimit Kombëtar për Qeverisje të Hapur siguron një strukturë formale për komunikim të rregullt, shumëpalësh dhe bashkë-bërje midis qeverisë dhe aktorëve kryesorë të shoqërisë civile dhe palëve të tjera jo qeveritare. Ky proces është krijuar për të arritur përfitime reale në transparencë, përgjegjshmëri, pjesëmarrje dhe konsultim.

Hyrje

Komiteti Shumë-Palësh i Këshillimit Kombëtar për Qeverisje të Hapur ("Komiteti") siguron takime të rregullta për të promovuar dialogun mes palëve të interesuara mbi politikat e hapura të qeverisë, këshillimin kombëtar me fokus në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e Veprimit Kombëtar të Partneritetit për Qeverinë e Hapur. Këshillimi është konsultativ, me fokus në ndërtimin e konsensusit, veprimeve kolegjiale dhe bashkë-krijimin. I informuar nga standardet e pjesëmarrjes dhe bashkë-krijimit të Qeverisjes së Hapur (OGP), ky mekanizëm dialogu pritet të zhvillojë dhe thellojë bashkëpunimin me anëtarët e Këshillit dhe palët e tjera të interesuara të angazhuara.

Komiteti promovon një anëtarësim shumë efektiv, jopartiak, të larmishëm për të mbështetur në dialogun gjithëpërfshirës.

Komiteti është vetëm një element i angazhimit të qeverisë për t'u konsultuar dhe këshilluar gjerësisht me palët e interesuara për çështje të hapura të qeverisë, përfshirë siç kërkohet nga Iniciativa Globale (OGP) dhe ka për qëllim të plotësojë, jo të zëvendësojë, mjete të tjera të konsultimit.

Ky dokument përshkruan anëtarësimin, aktivitetet, rregullat dhe proceset e Komitetit. Detajet e procesit do të bien dakord nga anëtarët e Komitetit në mënyrë të vazhdueshme (p.sh. metoda specifike etj). Kjo rregullore mund të ndryshohet bazuar në mësimet e marra si pjesë e rishikimit të përshkruar në seksionin e Vlerësimit.

Takimet

- **Frekuenca:**

Komiteti mbledhet, si rregull, jo më pak se tre herë në vit, në një kohë të përshtatshme dhe dakortësuar nga anëtarët. Sidoqoftë, kur hartohet Plani Kombëtar i Veprimit, Komiteti mund

të takohet më shpesh për të bashkëpunuar në procesin e bashkë-bërjes dhe zhvillimit të Planit.

- **Pjesëmarrja:**

Sekretariati i Komitetit lehtëson organizimin e mbledhjeve fizike, në distancë apo hibride, përmes telekonferencave ose videokonferencave, duke konsideruar dhe transmetime direkte me mbështetjen e AKSHI-t.

Në rast pamundësie të pjesëmarrjes në mbledhjet e Komitetit anëtarët me detyrë ministra, sipas pikës 3 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 145 datë 20.12.2021, ndryshuar me Urdhrin nr. 177, datë 28.10.2022, mund t'ia delegojnë pjesëmarrjen në mbledhjet e Komitetit, zëvendësministrave.

- **Vendndodhja:**

Mbledhjet e Komitetit në prezencë apo hibride mbahen në mjediset e godinës së Kryeministrit.

- **Pjesëmarrja e të ftuarve:**

Komiteti mund të zhvillojë mbledhje me anëtarët e tij dhe mbledhje të hapura me të ftuar të tjerë sipas përcaktimeve në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145 datë 20.12.2021, ndryshuar me Urdhrin nr. 177, datë 28.10.2022.

- **Minutat e takimeve:**

Sekretariati përgatit minutat e takimeve, të cilat i përcillen për mendim anëtarëve të Komitetit brenda 5 ditësh pune nga zhvillimi i takimit. Nëse brenda 5 ditësh të tjera pune nuk ka komente apo sugjerime për minutat e takimit të përcjella, minutat konsiderohen të miratuara.

Anëtarësia dhe drejtimi

Komiteti Shumë-Palësh përbëhet nga anëtarët e parashikuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 145 datë 20.12.2021 ndryshuar me Urdhrin nr. 177, datë 28.10.2022 dhe bashkë-drejtohet në rolet e bashkë-kryetarëve, nga Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, si dhe nga një përfaqësues i zgjedhur nga radhët e anëtarëve të shoqërisë civile në Komitet, i cili përcaktohet nga vetë anëtarët e shoqërisë civile dhe komunikohet në mbledhjen e parë të Komitetit, në zbatim të ligjit Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile KKSHC”. Bashkë-Kryetarët përgatisin agjendat e mbledhjeve duke marrë në konsideratë propozimet e anëtarëve.

- **Përzgjedhja e bashkë-kryetarit dhe anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile:**

Anëtarët e organizatave të shoqërisë civile në Komitet zgjidhen dhe shkarkohen në përputhje me ligjin Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile KKSHC”.

Procesi i propozimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të Komitetit nga radhët e OJF-ve kryhet sipas procedurave, kritereve dhe afateve që parashikohen në ligjin Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile KKSHC”.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ngarkohet për dërgimin e përfaqësueve të shoqërisë civile anëtarë të Komitetit, sipas fushave të parashikuara në pikën 3 të Urdhrit, parashikuar në ligjin Nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile KKSHC”.

Sekretariati

Sekretariati i Komitetit është strukturua në nivel teknik, në Kryeministri, operon në përputhje me detyrat e parashikuara në Urdhrin nr. 145 datë 20.12.2022, dhe në këtë rregullore. Sekretariati asiston bashkë-kryetarët në përgatitjen e agjendave të takimeve, mban minutat e takimeve, si dhe përcjell AKSHI-t materialet për publikim në faqen e OGP si agjendat e takimeve dhe procesverbalet, si dhe materiale të tjera sipas kërkesave të Komitetit

Komunikimi

Komunikimi në kohë dhe i qartë siguron transparencë dhe përgjegjësi për palët e jashtme të interesit. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit publikon të gjithë procedurat dhe dokumentacionin e mbledhjeve apo materialeve promovuese, të cilat vihen në dispozicion nga Sekretariati.

- **Mjetet:**

Komiteti dhe anëtarët mund të komunikojnë midis takimeve përmes postës elektronike, gjithashtu mund të komunikojnë me aktorë të jashtëm përmes faqeve të internetit, gazetave, mediave sociale, etj.

Faqja e vetme zyrtare është faqja e Qeverisjes së Hapur <https://ogp.gov.al> që administrohet nga ana teknike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe nga përmbajtja nga Sekretariati, ku do të përditësohen të gjithë evidencat e mbledhjeve¹, takimeve, promovimeve, njoftimeve etj.

- **Përgjegjësia:**

Komiteti publikon procesverbalet dhe agjendat e takimeve brenda dy javësh, pasi merr konfirmimin nga anëtarët. Anëtarët mund të bien dakord të publikojnë dokumente shtesë në lidhje me aktivitetet e Komitetit.

¹Shënimet e mbledhjes, agjendat, materialet, konkluzionet operacionale, etj.

Komiteti publikon agjendat e mbledhjeve të ardhshme të paktën dy javë përpara datës së përcaktuar për takimin.

- **Pjesëmarrja:**

Komiteti publikon njoftime të takimeve në faqen web të Qeverisjes së Hapur, si dhe përgatit çdo lloj njoftimi tjetër për pjesëmarrjen e publikut. Gjithashtu, i jep mundësi publikut për të komentuar para takimeve dhe/ose publikon njoftime të tjera për publikun.

Roli dhe përgjegjësitë

Komiteti:

- siguron përfshirjen e shoqërisë civile në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha iniciativat dhe aktivitetet që ai ndërmerr në kuadër të OGP.
- Komunikon me OGP në kuadër të përgatitjes së planit të veprimit duke marrë parasysh eksperiencat më të mira ndërkombëtare.
- Bashkëpunon dhe siguron marrjen e mendimit nga institucione dhe agjenci të tjera të përfshira në aspekte të rëndësishme që mund të evidentohen gjatë procesit të përgatitjes së planit të veprimit.
- Ndërvepron me IRM për të mundësuar informacionin e nevojshëm, i jep informacion në lidhje me institucionet përgjegjëse, si dhe jep komentet respektive në lidhje me raportet e IRM.
- Siguron që rekomandimet e raporteve të IRM të implementohen nga institucionet respektive në vend.
- Komiteti siguron pjesëmarrjen e të gjithë palëve të interesuara në procesin e OGP dhe mundëson që aktorë të tjerë jo qeveritarë si akademia apo sektori privat të angazhohen në procesin e OGP.
- Komiteti siguron përmes AKSHI që të mundësohet pjesëmarrja online e aktorëve që nuk kanë mundësi të marrin pjesë në takimet më prezencë fizike.
- Komiteti siguron që publiku të njihet me reformat dhe proceset qeveritare me qëllim gjithë përfshirjen në to.
- Komiteti monitoron ecurinë e procesit të OGP, zhvillimin, monitorimin dhe implementimin e planit të veprimit.
- Komiteti cakton një prej anëtarëve të tij që të monitorojë webfaqen e OGP, me qëllim që të sigurohet përditësimi i vazhdueshëm i saj dhe publikimi aty i të gjitha materialeve të parashikuara në manualin e OGP, si dhe këtë rregullore, si dhe që informacioni dhe gjuha e

përdorur të jetë lehtësisht e kuptueshme nga publiku i gjerë, por dhe nga kategoritë që kanë kufizime të shikimit dhe dëgjimit. Webfaqja duhet të plotësojë kërkesat e parashikuara në manualin e OGP. Anëtarët i ngarkuar nga Komiteti raporton në mënyrë periodike në Komitet në lidhje me realizimin e sa më sipër.

Aktivitetet nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë aktivitetet që Qeveria ka planifikuar tashmë, siç janë konsultimet online dhe takimet konsultative për të zhvilluar Planin Kombëtar të Veprimit të OGP.

Aktivitete

Komiteti mund të ndërmarrë çdo veprim që beson se do të çojë më tej qeverisjen e hapur.

Aktivitetet nuk kanë për qëllim të zëvendësojnë aktivitetet që qeveria ka planifikuar tashmë, siç janë konsultimet online dhe takimet konsultative për të zhvilluar Planin Kombëtar të Veprimit të OGP.

Hartimi i Planit Kombëtar

Komiteti siguron:

- Angazhimin e shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në hartimin e Planit Kombëtar të Qeverisjes së Hapur.
- Organizimin e aktiviteteve informuese në lidhje me procesin e hartimit të planit të veprimit për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm në lidhje me procesin e hartimit të planit të veprimit dhe të mundësojë dhënien e mendimeve të tyre në këtë proces, duke ftuar dhe përfaqësues nga kategoritë e marginalizuara apo nënpërfaqësuar.
- Organizimin e aktiviteteve të dedikuara për grupet e aktorëve të identifikuar gjatë planifikimit të hapave të planifikimit të procesit, duke përfshirë departamente/agjenci qeveritare, degë të qeverisjes, grupe të shoqërisë civile, përfaqësues të organizatave /rrjeteve të kategorive të marginalizuara, sektorin privat, dhe grupe specifike përfituese. Siguron që përfshirja të bëhet në përputhje me manualin e OGP.
- Këto aktivitete mund të shfrytëzohen dhe për të mbledhur informacion nga pjesëmarrësit në lidhje me çështje të transparencës, përgjegjshmëria dhe pjesëmarrjes qytetare që do të duhet të adresohet ose rishikohet, apo duke hapur thirrje për dërgimin e ideve online apo qarkullimin e pyetësorëve online. Komiteti siguron që pyetjet dhe mbledhja e përgjigjeve të strukturohet në bazë të objektivave të procesit të përgatitjes së planit të veprimit, si dhe që përgjigjet e aktorëve të dokumentohen dhe regjistrohen në mënyrën që lehtëson përmbledhjen e tyre, duke siguruar zhvillimin e një mekanizmi që mbledh mendimin nga një kategori e gjerë aktorësh për një kohë të përshtatshme për këtë mekanizëm.
- Komiteti mund të përfshijë vendosjen e prioriteteve tematike, identifikimin e problemeve për zgjidhjen dhe/ose sugjerimin e ideve për angazhime.
- Rishikimin e propozimeve të angazhimeve përmes një procesi të hapur dhe transparent.
- Nëse gjatë procesit dalin ide të reja, Komiteti siguron organizimin e aktiviteteve të tjera si më sipër me qëllim diskutimin e tyre.

- Komiteti prioritetizoj objektivat e planit të veprimit nëse gjatë procesit një numër i konsiderueshëm objektivash janë propozuar.
- Identifikon zgjidhjet e mundshme bazuar në mendimet e ardhura.
- Publikimin në faqen e OGP të afateve për përgatitjen e planit të veprimit dhe një përmbledhje të mundësive për aktorët e interesuar për të marrë pjesë në këtë proces të paktën 2 javë para fillimit të procesit të përgatitjes së planit të veprimit.
- Komiteti siguron që aktorëve propozues apo kontribuues në proces t'i kthehet një përgjigje e arsyetuar në lidhje me vendimmarrjen për përfshirjen, modifikimin apo mospranimin e propozimit, në përputhje me përcaktimet në manualin e OGP.
- Organizon një event publik për prezantimin e planit të veprimit me pjesëmarrje të nivele të larta përfaqësuese.
- AKSHI siguron që webfaqja e OGP të jetë e përditësuar dhe mirëmbajtur në mënyrë të vazhdueshme, si dhe që mendimet e ardhura gjatë procesit të publikohen aty në vazhdimësi së bashku me përgjigjen respektive për sa më sipër.
- Komiteti siguron angazhimin e ekspertit/ekspertëve për të mundësuar draftimin e planit të veprimit dhe përfshirjen në të, të sugjerimeve të ardhura gjatë procesit, bazuar në manualin e OGP, i cili do të kalojë në shqyrtim në Komitet, i cili miraton në përfundim të procesit planin dhe ia përcjell OGP për mendim brenda afateve të parashikuara në manualin e OGP

Komiteti mund të:

- Identifikojë organizatat nga radhët e OJF-ve si 'kampione' të angazhimeve.

Implementimi i Planit

Komiteti do të:

- Vlerësojë dhe komunikojë publikisht progresin e angazhimeve të Planit Kombëtar për Qeverisjen e Hapur.

Komiteti do të:

- a) shqyrtojë dhe fusë në zbatim Planin Kombëtar për Qeverisje të Hapur, si dhe të sigurojë drejtimin për zbatimin dhe raportimin e institucioneve për ecurinë e tij;
- b) nxisë bashkërendimin në nivel të lartë të institucioneve, me qëllim orientimin dhe udhëheqjen e punës për zbatimin e politikave dhe masave për arritjen e angazhimeve për qeverisje të hapur;
- c) nxisë dialogun në kuadrin e politikave dhe lidhjes së tyre në zbatim të qeverisjes së hapur;
- d) shqyrtojë raportet e vetëvlerësimit të arritjes së masave për vendin, të përgatitura nga sekretariati, si dhe të japë rekomandime dhe porosi për përmirësim;
- e) shqyrtojë raportet e vlerësimit nga mekanizmi i pavarur i Qeverisjes së Hapur për vendin;
- f) rekomandojë masat e nevojshme ligjore, si dhe të orientojë punën organizative për nisma ligjore për arritjen e angazhimeve;

- g) nxisë planifikimin për financimin e masave përmes programimit buxhetor afatmesëm, bashkëpunimit me partnerët e zhvillimit, përmes sistemit të planifikimit të integruar (SPI);
- h) organizojë të paktën dy takime vjetore me shoqërinë civile për të prezantuar rezultatet e implementimit të planit të veprimit dhe për të mbledhur komentet dhe sugjerimet e tyre;
- i) nxisë dialogun e Këshillit të Ministrave me institucionet e pavarura, organet e vetëqeverisjes vendore, partnerët për zhvillim, shoqërinë civile, për zbatimin e masave, si dhe të promovojë nismat e veprimeve të bashkërenduara në këtë kuadër.

Vetëvlerësimi afat-mesëm

Komiteti do të duhet të:

- japë opinion dhe sugjerime lidhur me raportet e vetëvlerësimeve.

Komiteti:

- do të përgatisë një përmbledhje ekzekutive të Raporteve të Vetëvlerësimeve, e cila do të shoqërojë raportin e progresit.

Mekanizmi i Pavarur i Vlerësimit

Komiteti do të:

- Informojë lidhur me aktivitetet dhe të identifikojë fushat e përmirësimit.
- Komiteti mban kontakte me IRM gjatë periudhave të vlerësimeve dhe realizon sa parashikohet në rolin dhe përgjegjësitë e tij.

Kjo rregullore publikohet nga AKSHI në website e OGP për Shqipërinë pas miratimit të saj nga Komiteti.